



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

Nr\_\_\_\_ Prot

Datë 05/11/ 2009

**V E N D I M**

**Nr. 128 Datë 05.11.2009**

**Mbi**

**“Autorizimin e përqendrimit për përfitim e kontrollit të vetëm në shoqërinë BKT SHA, nga shoqëria Çalik Finasial Hizmetler AS nëpërmjet blerjes të totalit 40% të aksioneve të zotëruara nga IFC dhe BERZH “**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e :

- |                            |         |
|----------------------------|---------|
| ▪ Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar |
| ▪ Znj. Servete Gruda       | Anëtar  |
| ▪ Z. Koço Broka            | Anëtar  |
| ▪ Znj. Rezana Konomi       | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 05.11.2009, shqyrtoi çështjen me :

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit për përfitim e vetëm të kontrollit në shoqërisë Banka Kombëtare Tregtare SHA, nga shoqëria Çalik Finasial Hizmetler AS nëpërmjet blerjes së totalit prej 40% të aksioneve të aksionerëve IFC dhe BERZH.

**Baza ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, Kreu IV “Procedurat për kontrollin e përqendrimeve” nenet 53-56, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Aneksi I - Formulari “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Raportit të Sekretariatit dhe Relacionit të Sekretares së Përgjithshme bashkëlidhur këtij raporti

## V Ë R E N S E:

### Palët:

**Banka Kombëtare Tregtare ShA (BKT)**, me seli në Tiranë, është një shoqëri anonime, e licensuar nga Banka e Shqipërisë, sipas licensës Nr. 6/1998, datë 11.01.1999, për të ushtruar veprimtarinë si bankë në përputhje me ligjin nr. 8365, datë 2.7.1998 „Për bankat në Republikën e Shqipërisë“ .

BKT-ja operon me seli qendrore në Tiranë dhe ka rrjetin e vet në Republikën e Shqipërisë që përbëhet nga 23 degë dhe 23 agjensi. Gjithashtu BKT ushtron veprimtarinë e vet edhe në Kosovë nëpërmjet 5 njësive.

Banka Kombëtare Tregtare Sh.A (BKT) ofron një spektër të plotë shërbimesh bankare, me një total aktivesh për vitin 2008 në masën xxxx milionë dollarë . Aktualisht, BKT u ofron shërbime bankare ndërmarrjeve shtetërore, private e individëve.

Struktura e BKT Sh.A përbëhet nga 3 aksionerë: Çalik Finansial Hizmetler A.S (60%+2); BERZH(20%-1); IFC (20%-1) .

**Shoqëria Çalik Finansial Hizmetler, në cilësinë e blerësit**, me seli në Stamboll, Turqi, e krijuar dhe që funksionon sipas legjislacionit turk, aksionere për pjesën 60%+2 në Bankën Kombëtare Tregtare. Objekti dhe fusha e veprimtarisë së shoqërisë është realizimi i investimeve nëpërmjet interesave në bankat vendase dhe të huaja, ofrimi i konsulencës financiare për bankat dhe shoqëritë e faktoringut, lizingu etj brenda dhe jashtë vendit.

**Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), në cilësinë e shitësit**, është aksioner/ zotërues i pjesës 20%-1 të kapitalit e barabartë me 492.884 aksione. **BERZH**, është një bankë multilaterale e themeluar në bazë të një traktati ndërkombëtar në maj të vitit 1990, me qendër në Londër. Shqipëria është anëtare e kësaj banke qysh prej vitit 1991.

**Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), në cilësinë e shitësit**, është aksioner zotërues i pjesës 20%-1 të kapitalit e barabartë me 492.884 aksione. **IFC**, është pjesë e grupit të Bankës Botërore, e krijuar në vitin 1956 nga shtetet anëtare të saj, me seli në Washington D.C, USA.. Shqipëria është anëtarësuar në IFC, në tetor të vitit 1991.

Qëllimi i këtyre dy institucionive është nxitja e zhvillimit ekonomik duke inkurajuar përhapjen e bizneseve prodhuese private, veçanërisht në zonat më pak të zhvilluara duke:

- Ndiheuar në financimin e krijimit, zgjerimit, modernizimit të ndërmarrjeve prodhuese private, nëpërmjet investimeve të pagarantuara nga shteti anëtar përkatës, përfshirë edhe rastet kur kapitali privat nuk është i mjaftueshëm dhe i disponueshëm;
- Krijuar mundësira investimi, duke grumbulluar kapital vendas dhe të huaj; dhe

- Stimuluar dhe krijuar kushte favorizuese për rrjedhjen e kapitalit privat vendas dhe të huaj në industrinë e vendeve anëtare të saj.

## **Përqendrimi**

Subjekt i përqendrimit është shoqëria BKT SHA. Transaksioni i synuar konsiston në blerjen e çdonjerës nga pjesët prej 20%-1 të aksioneve të zotëruara nga BERZH & IFC në BKT SHA, nga aksioneri/shoqëria Calik Financjal Hizmetler. Në përfundim të transaksionit, shoqëria Calik Financjal Hizmetler A.S, do të zotërojë 100% të aksioneve në BKT SHA

Vlera e gjithë transaksionit kap shumën xxxxxxxxxx \$.

## **Xhiro për vitin 2008**

Referuar nenit 12, pika 1, xhiro totale **në tregun e brendshëm** e BKT-së është rreth xxx miliardë lekë.

**Tregu përkatës:** Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do konsiderohet tregu bankar, ku pjesa e tregut që zë BKT është xxx %.

**Tregu përkatës i produktit** Të gjitha shërbimet e ofruara nga palët në këtë transaksion dhe të përcaktuara edhe në licensën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë janë konsideruar produkte dhe përfshihen në tregun e produktit.

BKT SHA, për vitin 2008 zotëron xxx % të tregut të depozitave; xxx % të tregut të kredive; xxx % të tregut të depozitave.

**Tregu gjeografik:** Rrjeti aktual i BKT SHA që përfshin degë e agjensi në territorin e Republikës së Shqipërisë.

### *Tregje të prekura*

Në bazë të përkufizimit të tregjeve të prekura sipas seksionit 6(III) të “Formularit të njoftimit të përqendrimit”, nuk ka tregje të prekura nga përqendrimi i njoftuar as horizontalisht dhe as vertikalisht, mbasi nga të gjitha shoqëritë pjesmarrëse në transaksion, vetëm BKT SHA ushtron veprimtari bankare në tregun përkatës.

## **Si konkluzion,**

Transaksioni i njoftuar konsiston në përfundimin e kontrollit të vetëm në Bankën Kombëtare Tregtare SHA, nëpërmjet blerjes së aksioneve të zotëruara nga BERZH dhe IFC, në favor të aksionerit mazhoritar Çalik Financjal Hizmetler A.S.,

Ky transaksion sjell reduktimin e numrit të aksionerëve dhe ndryshimin e formës së kontrollit, nga kontroll i përbashkët në kontroll të vetëm.

Në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja b dhe pikës 2, shkronjave a dhe b, të Ligjit Nr 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, transaksioni i njoftuar konsiderohet përqëndrim.

Nga vlerësimi rezulton që ky transaksion nuk shkakton asnjë pasojë në strukturën e tregut bankar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 24, shkronjat d, dhe nenit 56, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar,

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqëndrimin e realizuar për përfitim të vetëm të kontrollit në shoqërinë Banka Kombëtare Tregtare SH.A, nga shoqëria Çalik Finansial Hizmetler AS nëpërmjet blerjes të aksioneve të zotëruara nga IFC dhe BERZH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete Gruda**  
(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Rezana Konomi**  
(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Koço Broka**  
(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Lindita Milo (Lati)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R E**